



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[Dt.24.01.2023]

OPERATORIT EKONOMIK “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK

**Adresa: Tirane Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9. Njesia administrative Nr. 7, 1023,
Tirane.**

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur (mbi kufirin e lartë monetar).**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Projekti i centralizimit të nyjeve semaforike me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të Trafikut”** me Nr. REF: 50064-11-15-2022 për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme *(nëse është rasti)*: Buletini Nr. 160 datë 21 Nëntor 2022

Publikimet e mëparshme *(njoftimi i fituesit paraprak)*: Buletini Nr. 4 datë 16 Janar 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Operatori ekonomik “H O R I Z O N” shpk NUIS K52225004V**

Vlera e ofertës pa tvsh = 79.976.500 (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë.

- **Operatori ekonomik “ALBTELECOM” sha NUIS J61824053N**

Vlera e ofertës pa tvsh = 0 (zero) lekë.

- **Operatori ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK me NUIS K01625001C**

Vlera e ofertës pa tvsh = 78.209.000 (shtatëdhjetë e tetë milion e dyqind e nëntë mijë) lekë nga ku çmimi i ofertës për shërbimet është 42.141.000 (dyzet e dy milion e njëqind e dyzet e një mijë) lekë pa tvsh dhe çmimi i ofruar për Apartaura dhe Pajisje është 36.068.000 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “H O R I Z O N” shpk NUIS K52225004V**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “H O R I Z O N” shpk shpk nga ku rezultoi si vijon:

1. AK Ne kriteret e vecanta per kualifikim ne piken 1 gërma (a) ka kërkuar se “Ofertuesi duhet te paraqesëSigurimin e ofertes sipas shtojces Nr .3 “

Nga verifikimi qe ka kryer Komisioni i Vlerësimit te Ofertave u konstatua se operatori ekonomik “Horizon” shpk nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes duke rënë në kundërshtim me përcaktimin e bërë si më sipër shënuar si edhe me përcaktimin e bërë në nenin 83 te ligjit nr 162/2020 per “Prokurimin Publik” si edhe në nenin 30 pika 1 te VKM nr 285 dt 19.05.2021 per “Miratimin e rregullave te prokurimit publik” (i ndryshuar) ku cilësohet se:

“Autoriteti kontraktor **duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së”.**

Pra sigurimi i ofertes është kriter i detyrueshëm për tu plotësuar nga ofertuesit e mundshëm ekonomikë.

- 2 Në rubrikën “Kapaciteti ekonomik dhe financiar “ pika 2.2/2.2.2 është kërkuar si më poshtë vijon:

“Kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, **të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet**, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “H O R I Z O N” shpk në përmbushje të këtij kriteri u konstatua se bilanci i vitit 2021 është **i pakonfirmuar** nga Drejtoria e Tatim taksave duke rënë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në kriterin si më sipër cituar.

3.Në pikën 2.3.3 të kriteve të vecanta për kualifikim rubrika “Kapaciteti teknik” është kërkuar se:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për aparaturat/pajisjet e zërit 3, si dhe për softëare e platformës së menaxhimit. Në rast të paraqitjes së autorizimit të distributorit, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumenta për të vërtetuar lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi”.

Operatori ekonomik “H O R I Z O N” shpk nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi/distributori duke mos plotësuar kështu kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriteve të vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarde të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- **Operatori ekonomik “ALBTELECOM” sha NUIS J61824053N**
Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALBTELECOM shpk nga ku rezultoi si vijon:

Operatori Ekonomik “ALBTELECOM” sha nuk përmbush asnjë prej kriteve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat standarde të tenderit, për këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi pasi nuk ka paraqitur oferte teknike, ekonomike-financiare edhe ligjore, ka paraqitur vetem Licensat AKEP dhe vertetim statusi aktiv.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“COMMUNICATION PROGRESS” shpk**, me adresë: **Tirane Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9. Njesia administrative Nr.7, 1023, Tirane** se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 78.209.000 (shtatëdhjetë e tetë milion e dyqind e nëntë mijë) lekë nga ku çmimi i ofertës për shërbimet është 42.141.000 (dyzet e dy milion e njëqind e dyzet e një mijë) lekë pa tvsh dhe çmimi i ofruar për Apartaura dhe Pajisje është 36.068.000 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë me adresë Blv “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____